



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**STATUTI (QRK) NR. 01/2023 I SHËRBIMIT SPITALOR DHE KLINIK  
UNIVERSITAR TË KOSOVËS<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Statuti (QRK) NR. 01/2023 i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, është aprovuar në mbledhjen e 180-të, të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 29/180, datë 27.12.2023.

## **Qeveria e Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 8 paragrafi 4.5 dhe nenit 11 paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me Nenin 63 paragrafët 2 dhe 3, dhe nenin 23 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi,

Miraton:

## **STATUT (QRK) NR. 01/2023 I SHËRBIMIT SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PERGJITHSHME**

#### **Neni 1 Misioni**

Misioni i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (në vijim “ShSKUK”) është të sigurojë ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve shëndetësore cilësore, të sigurta dhe të qasshme për të gjithë, avancimin e kërkimeve shkencore, edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve mjekësorë dhe promovimin e kujdesit shëndetësor për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme.

#### **Neni 2 Qëllimi**

Me këtë Statut përcaktohet dhe rregullohet, fushëveprimi, organizimi, organet drejtuese, të drejtat dhe detyrimet, mënyrën e zgjedhjes së organeve drejtuese, njësitë përbërëse të ShSKUK-së, si dhe çështjet tjera që lidhen me kryerjen e veprimtarive dhe funksionimit të ShSKUK-ës.

#### **Neni 3 Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Statuti zbatohen në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe njësitë përbërëse të saj.

#### **Neni 4 Përkufizimet**

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë Statut kanë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Shëndetësi dhe legjislacionin tjetër përkatës.

## **KAPITULLI II**

### **EMËRTIMI, STATUSI, SELIA DHE VULAT**

#### **Neni 5**

##### **Emërtimi dhe statusi**

1. ShSKUK është institucion i shërbimit publik, që kryen veprimtari shëndetësore, edukative dhe kërkimore në fushën e shëndetësisë në pajtim me legjislacionin për shëndetësi dhe legjislacionin përkatës.
2. ShSKUK përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor siç përcaktohet me legjislacionin e shëndetësisë dhe me këtë statut.
3. ShSKUK është person juridik, vepron dhe merr pjesë në veprime juridike me emrin SHSKUK, në pajtim me legjislacionin përkatës.
4. Emri “ Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës”, vendoset në objektin/objektet ku kryhen aktivitetet e ShSKUK-ës.

#### **Neni 6**

##### **Selia**

1. Selia e SHSKUK-ës është në Prishtinë.
2. Ndryshimin e emrit dhe selisë të ShSKUK-ës, bëhet me Ligjin për Shëndetësi.

#### **Neni 7**

##### **Vula dhe logo**

1. ShSKUK dhe njësitë përbërëse të saj kanë vulën rrethore për vërtetimin e dokumenteve si dhe vulën katrore për protokollimin e dokumenteve sipas dimensioneve dhe kriterëve të përcaktuara me Ligjin përkatës për vula në institucionet e Republikës së Kosovës.
2. ShSKUK ka shenjën njohëse (logon), e cila miratohet nga Bordi Drejtues, që përfaqëson komponentët shëndetësore, arsimore dhe shkencore.
3. Njësitë përbërëse të ShSKUK-ës, kanë shenjën njohëse (logon) e tyre, të cilat përdorën së bashku me logon e ShSKUK-ës.
4. Për llojet, numrin, përbërjen, mënyrën e përdorimit si dhe autorizimin e personit për përdorimin dhe ruajtjen e vulave, vendos Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-ës, në pajtim me Ligjin përkatës për vula në institucionet e Republikës së Kosovës.

## **KAPITULLI III**

### **DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE PËRBËRJA E SHSKUK -ës**

#### **Neni 8**

##### **Detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e ShSKUK-ës me njësitë përbërëse janë:

1.1. Sigurimi i ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta për pacientët, përfshirë diagnostikimin, trajtimin, procedurat kirurgjikale, rehabilitimin dhe kujdesin parandalues;

1.2. Ofrimi i shërbimeve të specializuara dhe të kujdesit shëndetësor që mund të mos jenë në dispozicion në institucione të tjera të kujdesit shëndetësor;

1.3. Kujdesi për cilësinë dhe sigurinë e pacientit në kujdesin shëndetësor, duke respektuar standardet dhe protokollet mjekësore;

1.4. Trajnimi i studentëve të mjekësisë, profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor, bashkëpunëtorëve profesional përmes përvojës klinike dhe praktike;

1.5. Ofrimi i programeve arsimore dhe seminareve për të trajnuar dhe rritur aftësitë dhe njohuritë e profesionistëve të ardhshëm të kujdesit shëndetësor;

1.6. Mbështetja në edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit të kujdesit shëndetësor, duke siguruar të qëndrojnë të përditësuar me përparimet dhe praktikat më të fundit mjekësore;

1.7. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor klinik dhe spitalor emergjent.

1.8. Angazhimi në kërkime mjekësore, klinike dhe bashkëpunimi me partnerë akademikë për të avancuar njohuritë në fusha të ndryshme të mjekësisë dhe kujdesit shëndetësor.

1.9. Mbikëqyrja e kritereve dhe standardeve të punës që ndërlidhen me efikasitetin dhe indikatorët kyç të performancës për të gjitha njësitë në kuadër të ShSKUK-ës;

1.10. Vlerësimi, përditësimi, avancimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor përmes analizës së të dhënave të bazuara.

#### **Neni 9**

##### **Përbërja e ShSKUK-ës**

1. ShSKUK përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik si në vijim:

1.1. Qendra Klinike Universitare e Kosovës;

1.2. Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës;

- 1.3. Qendra Kombëtare e Telemjekësisë;
  - 1.4. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive;
  - 1.5. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës;
  - 1.6. Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë;
  - 1.7. Spitali i Përgjithshëm në Gjiçan;
  - 1.8. Spitali i Përgjithshëm në Pejë;
  - 1.9. Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë;
  - 1.10. Spitali i Përgjithshëm në Prizren;
  - 1.11. Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj;
  - 1.12. Spitali i Përgjithshëm në Vushtri;
  - 1.13. Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi;
  - 1.14. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime;
  - 1.15. Poliklinikat specialistike stomatologjike.
2. Funksionet e brendshme administrative dhe mbështetëse të ShSKUK-ës organizohen dhe kryhen nga administrata qendrore me seli në Prishtinë e cila është përgjegjëse për të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK-së.
3. Shërbimet nga Lista e shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor si dhe shërbimet nga Lista e Shërbimeve të kujdesit shëndetësor plotësues të përcaktuara sipas Ligjit për Shëndetësi ofrohen nga njësitë përbërëse të ShSKUK-ës.
4. Njësitë përbërëse të ShSKUK-ës, mundësojnë shërbime të integruara dhe të vazhdueshme, cilësore dhe të sigurt për të gjithë qytetarët në nevojë si dhe bashkëpunojnë e koordinohen me SHSKUK sipas këtij Statuti dhe në pajtim me legjislacionin e shëndetësisë.
5. Njësitë përbërëse të ShSKUK-ës, sipas paragrafit 1 të këtij neni udhëhiqen nga drejtorët/udhëheqësit të cilët i raportojnë Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-ës.
6. Në kudër të institucioneve të nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor, caktohet një Drejtor për arsim dhe shkencë, i cili propozohet nga radha e profesorëve të fakultetit përkatës të shkencave mjekësore. Funksioni i Drejtorit për arsim dhe shkencë është funksion shtesë i profesorit të caktuar në këtë pozitë dhe kompensohet sipas Ligj për pagat në sektorin publik të përcaktuar për funksione shtesë.

## **KAPITULLI IV**

### **ORGANIZIMI, QEVERISJA DHE MENAXHIMI I ShSKUK-ës**

#### **Neni 10**

##### **Organizimi i ShSKUK-ës**

1. ShSKUK organizohet në bazë të modelit që integron funksionet administrative dhe financiare me funksionet profesionale dhe kërkimore shkencore në sektorin publik të shëndetësisë, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me institucionet shëndetësore/njësitë organizative dhe shërbimeve përkatëse profesionale.
2. Autorizimet, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive përbërëse rregullohen me Statute të cilat përgatiten nga Bordi i ShSKUK-ës në bashkëpunim me njësitë përbërëse të ShSKUK-ës dhe miratohen nga ministri i shëndetësisë, në pajtim me Ligjin përkatës për Shëndetësi.
3. Organizimi i brendshëm i administratës në ShSKUK bëhet përshtatshëm me standardet e përcaktuara me legjislacionin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën publike.
4. Funksionet e brendshme administrative dhe mbështetëse të ShSKUK-ës organizohen dhe kryhen nga administrata qendrore e vendosur në Prishtinë e cila është përgjegjëse për të gjitha institucionet shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të ShSKUK-ës.
5. Për rritjen e efikasitetit të shërbimeve administrative, administrata qendrore mund të vendos nëpunës të saj nëpër njësitë përbërëse të ShSKUK-së, të cilët menaxhohen nga divizionet përkatëse të administratës qendrore.
6. Shërbimet teknike të njësive përbërëse të ShSKUK-ës organizohen dhe kryhen nga një njësi organizative në nivel divizioni i cili mund të themelohet në çdo njësi përbërëse të ShSKUK-ës.
7. Divizionet si në paragrafin 6 të këtij neni sa i përket menaxhimit dhe llogaridhënies vendosen në kuadër të Departamentin për Shërbime të Përgjithshme të administratës qendrore dhe i raportojnë drejtorit të këtij departamenti.

#### **Neni 11**

##### **Organizimi i shërbimeve shëndetësore në spitalet e përgjithshme**

1. Spitalet e përgjithshme si në nenin 9, paragrafi 1 i këtij Statuti, ofrojnë shërbimet shëndetësore si në vijim:
  - 1.1. Kirurgji e përgjithshme;
  - 1.2. Interno;
  - 1.3. Pediatri;
  - 1.4. Gjinekologji dhe Obstetrikë;

### 1.5. Emergjenca mjekësore.

2. Përveç shërbimeve shëndetësore të përcaktuara si në paragrafin 1 të këtij neni, Spitalet e Përgjithshme që përcaktohen si Qendra të specializuara mund të ofrojnë edhe shërbime të tjera shëndetësore terciare brenda zonës së përgjegjësisë e cila përcaktohet dhe miratohet nga Bordi Drejtues i ShSKUK-ës.

3. Shërbimet shëndetësore si në paragrafin 1 të këtij neni ofrohen përmes Reparteve të cilat janë njësi organizative themelore të Spitaleve të përgjithshme dhe udhëhiqen nga udhëheqësi i Repartit i cili i raporton Drejtorit të Spitalit të Përgjithshëm.

## **Neni 12** **Aktet e përgjithshme**

1. Akti themelor i përgjithshëm i ShSKUK-ës është Statuti.

2. Aktet tjera të ShSKUK-ës janë:

2.1. Rregullorja e punës e Bordit Drejtues;

2.2. Rregullorja e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;

2.3. Rregulloret dhe aktet tjera të nevojshme për ofrimin e shërbimeve dhe funksionimin e SHSKUK-së.

3. Aktet tjera të përgjithshme si në paragrafin 2 të këtij neni duhet të jenë në përputhje me Statutin e ShSKUK-ës dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Procedurën për miratimin, ndryshimin dhe plotësimin e Statutit dhe akteve tjera të përgjithshme të ShSKUK-ës e inicion Bordi Drejtues, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Bordi Drejtues, propozimin e Statutit të ShSKUK-ës dhe ndryshimeve të tij e dërgon te Ministri i Shëndetësisë për procedim dhe miratim në Qeveri.

6. Propozimin e akteve të brendshme për organizimin e njësive të SHSKUK-së ose ndryshimeve të tyre, Drejtori i përgjithshëm i dërgon për miratim te Bordit Drejtues.

## **Neni 13** **Organet drejtuese të ShSKUK-ës**

1. Organet drejtuese të SHSKUK-ës, janë:

1.1. Bordi Drejtues;

1.2. Drejtori i Përgjithshëm.

## **Neni 14**

### **Bordi Drejtues i ShSKUK-ës**

1. Bordi Drejtues është organ kolegjal i cili drejton ShSKUK-në dhe është organi më i lartë vendim-marrës në ShSKUK, i cili përbëhet, nga:

- 1.1. një (1) përfaqësues nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës;
  - 1.2. një (1) përfaqësues nga Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;
  - 1.3. një (1) përfaqësues nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës;
  - 1.4. një (1) përfaqësues nga Spitalet e përgjithshme, në bazë të rotacionit dhe përmbushjes së indikatorëve të kualitetit të shërbimeve shëndetësore;
  - 1.5. një (1) përfaqësues nga Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor, në bazë të propozimit të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës;
  - 1.6. një (1) përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë; dhe
  - 1.7. një (1) ekspert i menaxhimit shëndetësor me kualifikime të larta profesionale dhe shkencore i zgjedhur në bazë të konkursit publik.
2. Bordi Drejtues emërohet nga Qeveria në bazë të propozimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe i përgjigjet Qeverisë nëpërmjet Ministrit të Shëndetësisë;
3. Bordi Drejtues udhëhiqet nga Kryesuesi me mandat një (1) vjeçar i cili zgjidhet në bazë të parimit të rotacionit nga anëtarët e tij.
4. Bordi Drejtues mund të emërojë në cilësinë e vëzhguesit ekspertë vendor ose ndërkombëtar për mbështetje.
5. Puna e Bordit drejtues përcaktohet dhe rregullohet me Rregulloren e punës, e cila miratohet nga Bordi Drejtues.

## **Neni 15**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit Drejtues**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit Drejtues të ShSKUK-ës, janë:

- 1.1. Përcaktimi i planit zhvillimor institucional të ShSKUK-ës, përfshirë përcaktimin e misionit, vizionit dhe objektivave të ShSKUK-ës, si dhe miratimi i planeve operacionale për arritjen e këtyre objektivave;
- 1.2. Miratimi i buxhetit dhe pasqyrave financiare;

1.3. Monitorimi i performancës financiare dhe sigurimi që burimet financiare ndahen në përputhje me nevojat nga mbledhja e fondeve me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë financiare të ShSKUK-ës;

1.4. Mbështetja e Ministrisë së Shëndetësisë në zhvillimin dhe miratimin e politikave që drejtojnë funksionimin e shërbimeve shëndetësore, kujdesin ndaj pacientit, sigurinë dhe aspekte të tjera të ofrimit të kujdesit shëndetësor;

1.5. Propozimi dhe rishikimi i politikave dhe procedurave për qeverisjen e ShSKUK -së, përfshirë zhvillimin dhe miratimin e akteve të përgjithshme të cilat nuk janë në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qeverisë, kodeve të sjelljes dhe dokumenteve të tjera qeverisëse;

1.6. Sigurimi i cilësisë së lartë të kujdesit dhe sigurisë së pacientit përmes mekanizmave për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të ofruara të kujdesit shëndetësor si dhe respektimi i standardeve etike në ofrimin dhe kërkimin e kujdesit shëndetësor;

1.7. Emërimi, mbikëqyrja, lirimi nga detyra dhe vlerësimi i performancës të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-ës, sipas legjislacionit në fuqi;

1.8. Sigurimi që ofruesit e shërbimeve shëndetësore janë të përgatitur për emergjencat dhe fatkeqësitë dhe miratimi i planeve të gatishmërisë emergjente;

1.9. Propozimi i plotësimit ndryshimit të e Statutit të ShSKUK-ës, statuteve të njësive përbërëse, si dhe krijimi, shkrirja, ndarja dhe shpërbërja e njësive përbërëse të ShSKUK-ës në përputhje me nevojat e qytetarëve për shërbime shëndetësore, kriteret e performancës dhe efikasitetit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Statutin;

1.10. Nxjerrë dhe miraton aktet e brendshme për organizimin e klinikave të QKUK-së;

1.11. Propozimi dhe miratimi i partneriteteve strategjike me organizata të tjera të kujdesit shëndetësor, universitete ose institucione kërkimore, varësisht nga nevojat e ShSKUK-ës;

1.12. Raportimi i rregullt vjetor dhe tre mujor së bashku me deklaratën financiare dhe raportet e auditimit mbi aktivitetin e ShSKUK-ës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Qeverinë.

## **Neni 16**

### **Mbledhja, kuorumi dhe vendimmarrja e Bordit Drejtues**

1. Mbledhjet e Bordit Drejtues mbahet me prezencën fizike të anëtarëve, ndërsa me pëlqimin e shumicës së anëtarëve, mbledhjet mund të mbahet edhe përmes platformave tjera të përshtatshme të komunikimit nga distanca.

2. Mbledhjet janë të vlefshme nëse anëtarët janë njoftuar me rregull dhe në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

3. Nëse, në mbledhjen e thirrur nuk janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve, nuk ka kuorum, nuk mbahet mbledhja, por thirret një mbledhje e dytë me të njëjtin rend dite. Në këtë

rast, mbledhja e dytë është e vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm më shumë se një e treta (1/3) e anëtarëve të tij.

4. Vendimet e Bordi Drejtues merren me votim të hapur që realizohet me zë, me shenja apo çdo formë tjetër të përshtatshme, vendimet e Bordit Drejtues mund të miratohen edhe me një procedurë qarkulluese, në rast se asnjë anëtar nuk shpreh kundërshti.

5. Përrjashtimisht nga paragrafi 4 të këtij neni, vendimet që lidhen me zgjedhjen e një individi, merren me votim të fshehtë.

6. Vendimet e Bordi Drejtues merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, ndërsa vendimet me procedurë qarkulluese merren me shumicën e votave të anëtarëve të Bordi Drejtues.

7. Abstenimi apo votat e paplotësuara do të llogariten si vota kundër, në rast barazie të votave, vota e kryesuesit të Bordit Drejtues është vendimtare.

8. Në secilën mbledhje Sekretari i Bordit Drejtues mban procesverbalin ku shënohet data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që marrin pjesë, çështjet që diskutohen dhe pretendimet e anëtarëve, vendimet që merren si dhe forma dhe rezultati i votimeve.

9. Procesverbali si në paragrafin 8 të këtij neni paraqitet për miratim në fund të mbledhjes përkatëse ose në fillim të mbledhjes paraardhëse dhe pas miratimit, procesverbali nënshkruhet së bashku nga Kryesuesi i Bordit dhe Sekretari i Bordit Drejtues.

## **Neni 17**

### **Struktura organizative e administratës së SHSKUK-ës**

1. Struktura organizative e administratës të ShSKUK-ës, është si në vijim:

1.1. Bordi Drejtues

1.2. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK-ës;

1.3. Departamentet;

1.4. Divizionet.

2. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës i administratës së ShSKUK-ës, përcaktohet dhe rregullohet me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, e cila miratohet nga Bordi i ShSKUK-ës.

## **Neni 18**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK-ës, janë:

- 1.1. Zbatimi i objektivave dhe planeve zhvillimore në përputhje me misionin e ShSKUK-ës dhe në përputhje me vendimet e Bordit Drejtues;
- 1.2. Mbikëqyrja e përditshme e funksionimit të ShSKUK-ës duke siguruar ofrimin efikas dhe efektiv të shërbimeve të kujdesit shëndetësor;
- 1.3. Identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve, financiare dhe operacionale, përfshirë vlerësimin dhe zbutjen apo eliminimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në punën e ShSKUK;
- 1.4. Menaxhimi i buxhetit përfshirë të hyrat financiare, kontrollin e shpenzimeve dhe raportimin financiar si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të ShSKUK-ës;
- 1.5. Krijimi dhe siguri i një sistemi efikas të kontrollit të brendshëm financiar dhe identifikimi i mundësive për zvogëlim të shpenzimeve;
- 1.6. Menaxhimi me burimet njerëzore duke siguruar transparencë dhe meritë në punësim, vlerësim të performances për të siguruar që ShSKUK të ketë të punësuar të aftë dhe të motivuar;
- 1.7. Komunikimi me Bordin Drejtues, duke ofruar informata të përditësuara mbi aktivitetet, performancën financiare dhe iniciativat strategjike të ShSKUK-ës;
- 1.8. Sigurimi i zbatimit të legjislacionit, politikave dhe vendimeve të Bordit si dhe zgjidhjen e çështjeve komplekse që ndikojnë në realizimin objektivave të ShSKUK-ës;
- 1.9. Mbështetja dhe promovimi i standardeve etike dhe morale brenda ShSKUK, sigurimi i pajtueshmërisë me udhëzimet etike dhe nxitja e një kulture integriteti.
- 1.10. Zbatimi i emergjencave, duke përfshirë krizat e shëndetit publik, fatkeqësitë natyrore dhe ngjarje të tjera të papritura, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- 1.11. Kryen detyra tjera të përcaktuar me legjislacionin përkatës, Statutin e ShSKUK-ës, aktet e brendshme dhe vendimet e Bordit Drejtues.

## **Neni 19**

### **Përzgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-ës përzgjidhet me konkurs publik të shpallur nga Bordi Drejtues i SHSKUK-ës.
2. Mandati i Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK-ës është katër (4) vjeçar me mundësi vazhdimi edhe një mandat tjetër me të njëjtën kohëzgjatje.
3. Përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara me legjislacionin për zyrtaret publike për zyrtaret drejtues të lartë drejtues, kandidati për Drejtor të Përgjithshëm të ShSKUK-ës, nuk duhet të jetë anëtar i Bordi Drejtues të ShSKUK.

## **Neni 20**

### **Statusi i të punësuarve në ShSKUK**

1. Të punësuarit në ShSKUK dhe në njësitë përbërëse të saj kanë statusin e nëpunësit të shërbimeve publike siç përcaktohet me Ligjin për Zyrtares Publik, përjashtimisht anëtarëve të Bordit Drejtues.
2. Marrëdhënia e punës e të punësuarve në ShSKUK dhe në njësitë përbërëse të saj rregullohet me legjislacionin për zyrtaret publik dhe me Ligjin e punës, përjashtimisht anëtarëve të Bordit Drejtues.

## **Neni 21**

### **Pasuria dhe mjetet e punës të ShSKUK-ës**

1. Pasuria dhe mjetet e punës të ShSKUK-ës dhe nejtësve të saja përbëhen nga sende, të drejta dhe fonde të fituara përmes themelimit të saj, përmes shërbimeve të saj ose të marra nga Ministria si dhe nga burime të tjera sipas legjislacionit përkatës.
2. Pasuria dhe mjetet e punës si në paragrafin 1 të këtij neni, shfrytëzohen për veprimtarinë shëndetësorë si dhe për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me ligj.
3. Çdo formë e tjetërsimit të pasurisë dhe mjeteve të punës i nënshtrohet miratimit paraprak nga Ministria dhe lejohet vetëm për nevojat e ofrimit të shërbimeve shëndetësore ose të përmirësimit të performancës së kujdesit shëndetësor.
4. Në rast të shkatërrimit ose dëmtimit të pasurisë dhe mjeteve të punës, përjashtuar këtu shpenzimin ose amortizimin në kuadër të shfrytëzimit të rregullt, vlera e të cilit tejkalon njëmijë (1000) €, SHSKUK ka për detyrë të njoftojë Ministrinë për rastin dhe arsyet e shkatërrimit, përkatësisht të dëmtimit.
5. SHSKUK i dorëzon Ministrisë raportin vjetor që përmban inventarin e plotë të gjithë pasurisë dhe mjeteve të punës në posedim dhe shfrytëzim të saj dhe njësi të përbërëse, i cili dorëzohet jo më vonë se deri me në fund të muajit Shkurt të për vitin vijues.

## **Neni 22**

### **Financimi i ShSKUK**

1. ShSKUK financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burimet e tjera të përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi si dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Ministri duke siguruar transparencë të plotë të të gjitha burimeve financiare në relacion me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Qeverinë e Kosovës.
2. Në rast të afarizmit pozitiv financiar, institucioni shëndetësor – njësi përbërëse e ShSKUK-ës, ka të drejtë që në pajtim me vendimin e Bordit Drejtues, të realizojë pagesën për performancë për profesionistët shëndetësor, në pajtim me legjislacionin respektiv në fuqi.

## **Neni 23**

### **Pagesat për Shërbimet e ShSKUK**

1. Shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor, të ofruara nga njësitë përbërëse të ShSKUK-ës (institucionet shëndetësore), mund të shfrytëzohen pa pagesë nga kategoritë e qytetarëve dhe banorëve, të përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi.
2. Të gjithë qytetarët dhe banorët e tjerë mund t'i shfrytëzojnë këto shërbime duke marrë pjesë në koston e trajtimit nëpërmjet bashkë-pagesës, vlera e së cilës përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri, në pajtim me Ligjin për Shëndetësi.
3. Qytetarët dhe banorët të cilët janë klientë të kompanive të huaja (private ose publike), ose vendore (private) të sigurimeve shëndetësore mund t'i shfrytëzojnë këto shërbime bazuar në statusin e tyre të dokumentuar të sigurimit shëndetësor.

## **Neni 24**

### **Auditimi i ShSKUK-ës**

1. ShSKUK i nënshtrohet procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në pajtim me ligjin.
2. Në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar se ka shkelje të ligjshmërisë ose mos-përmbushje të detyrave nga ana e Bordit Drejtues të ShSKUK-ës, Drejtorit të Përgjithshëm ose njërive të saja përbërëse, Ministri i Shëndetësisë mund të kërkojë në çdo kohë auditimin e ShSKUK-ës nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës.
3. Në rastin kur raporti i auditimit e vërteton shkeljen ligjore ose mos-përmbushjen e detyrave nga ana e Bordit Drejtues të ShSKUK-ës, Ministri i Shëndetësisë mund të propozoj shkarkimin e Bordit Drejtues, dhe të iniciojë procedurat për emërimin e Bordit të ri, sipas Ligjit për shëndetësi.

## **Neni 25**

### **Drejtimi i njësive përbërëse të ShSKUK-ës**

1. Njësitë përbërëse të ShSKUK udhëhiqen nga drejtorët apo udhëheqësit e tyre.
2. Drejtorët apo udhëheqësit e njësive përbërëse të ShSKUK zgjedhën në bazë të konkursit publik, në pajtim me legjislacionin për zyrtaret publik dhe Ligjin e punës.
3. Drejtorët apo udhëheqësit si në paragrafi 1 të këtij neni, duhet të kenë të përfunduar shkollimin universitar në ndonjërin nga fushat: shkenca mjekësore, ekonomi, juridik, administratë, si dhe duhet të kenë gjashtë (6) vite punë profesionale prej tyre tri (3) menaxheriale.

## **Neni 26**

### **Transparenca e punës së ShSKUK-ës**

1. ShSKUK e informon publikun për punën e saj, organizimin e brendshëm dhe të gjitha informatat e rëndësishme për marrësin e shërbimeve shëndetësore përmes faqes zyrtare të saj.
2. ShSKUK e informon publikun për orarin e punës përmes faqes zyrtare duke theksuar orarin e punës së ShSKUK-ës dhe njësive përbërëse të saj.
3. Informacioni dhe të dhënat e ShSKUK-ës ofrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Raportet zyrtare mbi aktivitetet e ShSKUK-ës dhe qasjen në dokumentacionin përkatës mund t'u jepet mediave dhe personave të tjerë vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-ës, ose personi të cilin e autorizon me shkrim Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-ës.
5. ShSKUK do të mbajë informacionin ose qasjen në dokumentacion në përputhje me legjislacionin për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

## **Neni 27**

### **Sekreti afarist dhe profesional i ShSKUK-ës**

Sekretet afariste janë të gjitha dokumentet dhe të dhënat, zbulimi ose dhënia personave të paautorizuar do të ishte kundër afarizmit dhe interesave ShSKUK-ës ose do të dëmtonte reputacionin e ShSKUK-ës, si dhe interesat dhe reputacionin e punonjësve.

## **Neni 28**

### **Mbikëqyrja e ShSKUK-ës**

1. Mbikëqyrja e brendshme dhe e jashtme duhet të sigurojë zbatimin e dispozitave përkatëse ligjore, normave etike dhe profesionale, si dhe standardeve bashkëkohore në shëndetësi.
2. Mbikëqyrja e brendshme e ShSKUK-ës dhe njësive përbërëse, bëhet nga Bordi i ShSKUK-ës, Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-ës, Auditori i Brendshëm si dhe drejtorët e njësive përbërëse të ShSKUK për njësitë respektive.
3. Mbikëqyrja e jashtme ShSKUK-ës dhe njësive përbërëse, bëhet nga Ministria e Shëndetësisë, Odat e profesionistëve shëndetësorë, Inspektorati Qendror shëndetësor, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës si dhe organet e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 29**

### **Organizimi sindikal**

1. Në ShSKUK mund të veprojnë organizata sindikale ku punëtorët me anëtarësimin e tyre do t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e veta të garantuara me konventat ndërkombëtare të punës, ligjeve të aplikueshme dhe marrëveshjeve.

2. Anëtarësimi në organizatat sindikale është vullnetar dhe bëhet me deklaram individual.
3. Në rast greve të punëtorëve në ShSKUK duhet të sigurohet minimumi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, sipas akteve ligjore në fuqi.
4. ShSKUK zbaton obligimet dhe detyrat në pajtim me ligjin.
5. Përfaqësuesve sinidikal mund të ju ofrohet pjesëmarrja në mbledhjet e Bordit Drejtues të ShSKUK-ës dhe organeve drejtuese ekzekutive të njësive përbërëse të ShSKUK-ës në cilësinë e vëzhguesit, pa të drejtë vote, në pajtim me legjislacionin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

## **KAPITULLI V**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 30**

##### **Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

1. Çdo njësi përbërëse e ShSKUK-ës sipas këtij statuti, organizohet dhe funksionon në bazë të aktit nën ligjor, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, përmes Bordit Drejtues të ShSKUK-ës, në pajtim me ligjin.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti obligohen njësitë përbërëse të ShSKUK-ës që brenda afatit kohor prej 6 muajve të plotësojnë/ndryshojnë aktin nën ligjor aktual dhe të dorëzojnë për miratim nga Ministri i Shëndetësisë përmes Bordit Drejtues të ShSKUK dhe sipas legjislacionit në fuqi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, të punësuarit në administratë e ShSKUK, në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohen në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës.
4. Për njësitë përbërëse të ShSKUK-ës që nuk janë të zgjedhur drejtorët/udhëheqësit përkatës, deri në rekrutimin sipas dispozitave ligjore në fuqi, Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-ës ka të drejtë të caktoj ushtrues detyre/ zëvendësues të drejtorëve sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 31**

##### **Zbatimi i mëvonshëm**

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, neni 9 Paragrafi 1.15 fillon të zbatohet atëherë kur miratohet Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, përkatësisht kur poliklinikat stomatologjike në kuadër të Komunave përkatëse sistemohen në kuadër të kujdesit dytësor shëndetësor sipas ligjit për shëndetësi.

**Neni 32**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti shfuqizohet Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës i miratuar me vendimin Nr. 05/148 datë 11/09/2013.

**Neni 33**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës të Kosovës.

Albin KURTI

\_\_\_\_\_  
**Kryeministër i Republikës së Kosovës**

05 janar 2024